



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0294

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vjosa Gradinaj - Mexhuani, si paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Horn & Co. Kosova” SH.P.K - Prishtinë, kundër Njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ritender” me nr. të prokurimit: "643-23-10063-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Skenderaj, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me datën 09.07.2024:

Vendim

1. Aprovohet e bazuar ankesa e operatorit ekonomik, “Horn & Co. Kosova” SH.P.K, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 04/04/2024 (me numër protokollit 2024/0294) për aktivitetin e prokurimit me titull: “058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ri tender” me nr. të prokurimit: "643-23-10063-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Skenderaj, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.
2. Anullohet, Vendimi i Autoritetit Kontraktues (B58), për aktivitetin e prokurimit me titull: “058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ri tender” me nr. të prokurimit: "643-23-10063-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Skenderaj, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në rivlerësim.
3. Autoriteti Kontraktues urdhërohet që brenda një afati prej 5 ditësh të zbatojë vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së Nr. protokollit 2023/0892, i datës 19.01.2024, bazuar në nenin 105 paragrafi 2.10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Kurse nëse ky urdhër nuk zbatohet, do të ndërmirren veprime për marrjen e certifikatës ndaj zyrtarit që ka qenë përgjegjës dhe nuk ka vepruar sipas autorizimeve të dhëna nga ligjvënësi dhe vendimit paraparak, në përputhje me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues do të gjohet, sipas nenit 118 paragrafi 4 dhe 131 të LPP-së, për mosrespektimin e vendimit 892/23 të OSHP-së.
4. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Horn & Co. Kosova SH.P.K.”- me seli në Prishtinë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6

të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 28.03.2024, Komuna e Skenderajt në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 (Letër Standarde) për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “058 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje ndërtimi në Komunën e Skenderajt-Ri tender” me nr. të prokurimit: "643-23-10063-2-1-1", ku është shpërblyer me kontratë (GOE) N.N.P. Ndërtimi, Luigj Kastrati B.I me seli në Skenderaj.

Me 29.03.2024, Operatori Ekonomik “Horn & Co. Kosova SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK Komunën e Skenderajt.

Me 03.04.2024, Autoriteti Kontraktues Komuna e Skenderajt, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 28.03.2024.

Me 04.04.2024, Operatori ekonomik “Horn & Co. Kosova SH.P.K” ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 294/2024, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bje nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, sikurse parashihet me

nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Vendimi i AK-se për dhënie të kontratës, të anulohet ndërsa lënda të kthehet në ri-vlerësim

(c) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se Ankuesi nuk është deklaruar fare loidhur me raportin e cituar, Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se bazuar në ekspertizën e dhënë nga eksperti shqyrtues e pajtohem me raportin e ekspertit shqyrtues, prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën e ushtruar në rastin konkret.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Pretendimet ankimore të OE ankues sipas ankesës Nr. 294/24

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Komuna e Skenderajt gjegjësit Autoriteti Kontraktues edhe pse OSHP-ja e anulon vendimin për dhënie për here te pare i datës 31.10.2023 dhe e kthen ne rivlerësim Komuna e Skenderajt Autoriteti kontraktues ne mënyra jo profesionale, kundër ligjshme dhe duke i shkelur dispozitat ligjore të LPP-së nr.04/L-042 për here te dyte e shpërblen me kontratë te njëjtin Grup te operatorëve ekonomik Kompania Horn&Co.Kosova shpk pas vendimet për dhënie për here te dyte i datës 28.03.2024 edhe kundër vendimit te OSHP-se Nr:2023/0892 i datës 19.01.2024 na është lejuar të qasemi ne dokumentet zyrtar më datën 29.03.2024 të kompanisë qe autoriteti kontraktues mendon ta shpërblen me kontratë për here e dyte e qe është Grup i Operatorëve Ekonomik NNP Ndërtimi dhe Luigj Kastrati B.I Gjate kontrollit të dokumenteve nga ekspertet tanë të Grup i Operatorëve Ekonomik NNP Ndërtimi dhe Luigj Kastrati B.I qe autoriteti kontraktues ka menduar qe ta shpërblej më kontratë kemi gjetur shumë shkelje të kriterëve të dhënies se kontratës ndër to janë si ne vijim: 1. Çmimi ne shumë pozicionet ne paramasë është çmim jo- normalisht i ulet nde to janë pozicionet 1.1;1.2;1.3;2.1;2.2;2.3;2.4dhe 3.2 qe Grup i Operatorëve Ekonomik kane vendosur vlerën prej 0.118 qe vlera reale e tregut kap vlerën shumëfish ma te madhe. Ne pozicionin 3.2 Furnizimi ,shtrirja dhe rrafshimi i dheut nga kategoria e parë vlera qe Grup i Operatorëve Ekonomik ka vendosur ka qen vlera 0.118 për M3 ndërsa vlera momentale e tregut për 1M3 dhe te kategorisë se pare është nga 15 euro deri ne 20 euro. Ne pozicionin 2.2 Rrenim me Bager adekuat i objekteve e forta edhe te nalta Grup i Operatorëve Ekonomik kane vendosur si çmim vlerën prej 13.57 euro e qe veç shpenzimet për karburant edhe bagerist e kalojnë vlerën prej 50 Euro për ore.

Bashkëngjisë Paramasen e Grupit te Operatorëve Ekonomik NNP Ndërtimi dhe Luigj Kastrati B.I Te Çmimi përfundimtar ne paramasë qe grup i operatoreve ekonomik ka vendosur edhe Autoritet kontraktues ka menduar ta shpërblej me kontratë Çmimi i ofruar është Jonormalisht të Ulët ketë mund te shini edhe ne tabelën e Udhëzues Nr. 001/2023 Për Prokurimin Publik pika 11. Tenderët Jo-normalisht të Ulët 11.1 Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne kërkesën 3. Operatori ekonomik duhet ti ketë mjetet e stabilimentit si në vijim min. 3 (tre) kamion kiper. Grup i Operatorëve Ekonomik kanë dorëzuar ne E-Prokurim vetëm 2 kamion kiper ndërsa i treti ka qen Kamion Bore pastrues gjë qe nuk e ka plotësuar ketë krekës ne FDT 3. Grup i Operatorëve Ekonomik kanë dorëzuar edhe shume dokumente te cilat nuk ju përkasin konzerciumit. 4. Pas kërkesës tone për rishqyrtim herë te dyte i dt:29.03.2024 dhe pas refuzimit te kërkesës sonë i Dt: 03.04.2024 nga Autoriteti Kontraktues Komuna Skenderaj nga menaxheri i prokurimit jepen arsyetime qesharake jo profesionale gjeja qe kompania qe autoriteti kontraktues mendon ta shpërblej me kontratë ka marr disa oferta nga disa kompani tjera me vullnetin e saj te lire gjë qe ne si operator ekonomik na duktë se menaxheri i prokurimit gjegjësisht Autoriteti kontraktues ketë aktiviteti te prokurimit nuk e ka marr si garë ne mes te kompanive por e ka marr si pune qe ne çdo mënyrë duhet ta fitoj kompania qe ata mendojnë. Këto informata qe kompania i ka sjellur me vullnetin e saj te lire ne si operator ekonomik nuk ju besojmë po ashtu me vejnë keq qe Autoriteti kontraktues i merr si baze për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim. Bashkëngjisë Dokumentin e refuzimit te kërkesës për rishqyrtim Me të gjitha verifikimet e lartë cekura konstatojmë se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së nr.04/L-042 me nenet e poshtë shënuara, prandaj i kërkomë nga OSHP-ja që Ankesën tone ta aprovohet dhe oferta jone te ta shpallin fituese gjithashtu kërkoj te merren masa ndaj menaxherit te prokurimit gjegjësisht ndaj Autoritetit Kontraktues.

2. Përgjigje e AK në pretendimet e OE në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigje në Pretendimit Ankimor 1: Lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta. Ne ju sqarojmë se AK- Skenderaj gjatë fazës së vlerësimit ka zhvilluar komunikimin Inter partes, sipas nenit 41, par 41.2 te RrPP-se nr.001 duke kërkuar sqarime çmime jo normalisht të ulëta sipas shkresës së datës: 20.10.2023 dhe për këtë kemi pranuar përgjigjen nga OE N.N.P. Ndërtimi me datë: 23.10.2023, pas shqyrtimit dhe analizimit të përgjigjeve nga komisioni i vlerësimit kemi konstatuar se përgjigje sa i përket çmimeve jo normalisht te ulëta janë te detajuara mire, të qarta, si dhe shpjegimi se ‘Meqenëse në këtë tender nuk kërkohet ndonjë furnizim i materialeve të ndryshme por të gjitha pozicionet në paramasë janë vetëm punë që kryhen nga fuqi punëtore dhe makineri profesionale, duke ditur që kompania e jonë në qytetin e Skenderajt ka vend punishte ku kemi te pozicionuar makineri të ndryshme pra janë afër vendit ku do të ekzekutohen punimet për rrënimet të objekteve. Prandaj kjo kontratë për neve nuk krijon ndonjë kosto shumë të madhe shtesë meqenëse kemi kapacitetet e makinerisë të gjitha tonat poashtu kemi numër të mjaftueshëm të stafit profesional dhe punëtorëve që kemi me kontrata të rregullta, pra nuk kemi ndonjë kosto shtesë, si shembull (të bartim makinerinë e rëndë të dërgojmë në ndonjë qytet tjetër dhe të angazhojmë makineri me qira apo punëtorë shtesë për këtë projekt të caktuar sepse ne posedojmë makinerinë në pronësi ashtu edhe stafin dhe punëtorët). Për këtë si prove/dëshmi po bashkëngjis Makinerinë në pronësi, Listën e stafit te rregullt në ATK, si dhe Referencën pozitive për kontrate te njëjtë dhe pothuajse me te njëjtat çmime vitin e kaluar.’Përgjigjet për Autoritetin Kontraktues Komuna e Skenderajt, kane qene mjaft bindëse e bazuar me prova, dëshmi dhe argumente si dhe gatishmëria e OE ekonomik për te rritur edhe Sigurimin e Ekzekutimit, andaj duke ditur qe Autoriteti kontraktues vetë vlerëson nëse një tender është jo normalisht i ulët, si

dhe e drejta dhe përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktues për të trajtuar një tender apo pozicion të tenderit si jo normalisht të ulët, prandaj pas përgjigjeve të pranuar mjaft bindëse AK-Skenderaj në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi rekomandon për shpërbllim me kontrate OE me çmimin me të lirë të përgjegjshëm N.N.P. Ndërtimi.

3. Konstatimet e ekspertes shqyrtuese:

Eksperti shqyrtues, sqaron se ky aktivitet i prokurimit ka qene objekt i shqyrtimit ne Organin shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me c' rast është nxjerr raporti i ekspertizës me nr. 2023/0892 i datës 01.12.2023, si dhe Vendimi nga Paneli shqyrtues PSH.nr. 0892/2023 i datës 19.01.2024. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Horn & Co Kosova ka deponuar ankesën OSHP, kryesisht me pretendimin se nuk është respektuar vendimi i PSH-se nr. 892/23, po ashtu ne ankesën e tij me nr. 294/24 i ka parashtruar pretendimet ankimore te cilat janë te njëjta me ato ne ankesën me nr. 892/23. Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet ankimore te OE ankues lidhur me çmimet Jo/Normalisht te ulëta dhe pretendimet lidhur me kamionët kiper, eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje ne raportin me nr. 892/23 te datës: 01.12.2023.

Eksperti shqyrtues, lidhur me çmimin jo/normalishte te ulet sqaron se AK-ja, pas pranimit te vendimit me nr. 892/23, i ka kërkuar përsëri OE te rekomanduar për kontrate sqarime lidhur me çmimin, i cili ne përgjigje ka dërguar sqarime shtese te datës: 04.03.204 dhe 15.03.2024, të cilat gjenden në platformën e E-Prokurimit.

Eksperti shqyrtues pas analizimit te shkresave te lendes vlerëson se nuk është respektuar vendimi i PSH-se Nr. 892/23 lidhur me çmimet jo/normalisht te ulëta, pasi qe paneli shqyrtues ka konstatuar se: Paneli objektivisht arrin në përfundimin se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është ofertë jo-normalisht e ulët dhe duhet të refuzohet si ofertë e papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit, kurse shpjegimet plotësuese (të njëanshme) të OE të rekomanduar për kontratë përkitazi me arsyetimin e ofertës së tij nuk mund të merren në konsideratë në cilësi të provës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK-së, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues. Duke analizuar të gjitha këto në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështjeje, Paneli krijoi bindjen e tij të pavarur se ankesa e OE ankues duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Në këtë rast, Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar specifikisht në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet me dispozitat e neneve 113 dhe 114 të LPP-së. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues mbështet argumentet e dhëna të ekspertit shqyrtues, i cili pas analizimit të shkresave të lëndës, vlerëson se nuk është respektuar vendimi i PSH-së Nr. 892/23 lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta. Paneli Shqyrtues sipas vendimit paraprak te cituar kishte konstatuar, se oferta e OE të rekomanduar për kontratë konsiderohet ofertë jo-normalisht e ulët, për faktin parimor, se shpjegimet plotësuese (të njëanshme) të OE të rekomanduar për kontratë përkitazi me arsyetimin e ofertës së tij janë konsideruar jo të mjaftueshme dhe jo bindëse, për këtë panel, prandaj kishte gjykuar se as OE i rekomanduar, por as komisioni profesional brenda AK, nuk kishin ofruar fakte dhe prova bindëse se çmimet e ofruara te OE të rekomanduar konsistojnë të jenë çmime reale të tregut duke i dhënë të drejtë ankuesit lidhur me këtë çështje. Prandaj, pa qenë e nevojshme që të përsëriten të njëjtat detaje, ky panel e konsideron si çështje të gjykuar, ofertën e OE të rekomanduar për kontratë si jo e përgjegjshme, bazuar ne nenin 105.parag 2.16.

Nga ana tjetër, paneli sqaron se bazuar në këshillen juridike te vendimit të cituar si më sipër, nëse ndonjë palë në procedurë, përfshire edhe AK, mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues është në kundërshtim me faktet, provat ose me ligjin, ka pasur të drejtë ta atakojë vendimin e cituar pranë organeve kompetente. Kjo gjë nuk rezulton të jetë bërë, duke u bazuar në faktet dhe provat e paraqitura gjatë procesit të shqyrtimit. Në këto rrethana, ky panel sqaron se ky vendim konsiderohet i formës së prerë dhe moszbatimi eventual i tij kalon nën juridiksionin penal.

Paneli Shqyrtues , në këto rethana dhe në zbatim të kompetencave të parapara nga neni 105 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), sqaron se: Sipas nenit 105, paragrafi 2.10, OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi për të urdhëruar autoritetin kontraktues që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejme të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar. Gjithashtu, sipas nenit 105, paragrafi 2.16, në rastet e përsëritura me pretendime të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet ta trajtojë si çështje të gjykuar “res judicata”.

Prandaj, në rast se AK nuk vepron në harmoni me vendimet e këtij organi [892/23] brenda pesë (5) ditëve, do të ndërmerren masa administrative konform nenit 131 të LPP-së. Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues do të rezultojnë në vendosjen e një gjobe prej jo më pak se pesëmijë (5.000) Euro për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mosrespektimin e urdhrat të OSHP-së brenda pesë (5) ditëve. Kjo përfshin pa përjashtim edhe veprimet për marrjen e certifikatës ndaj zyrtarit që ka qenë përgjegjës dhe nuk ka vepruar sipas autorizimeve të dhëna nga ligjvënësi dhe vendimit paraprak të OSHP-së, në përputhje me nenin 25, paragrafët 8 dhe 9 të LPP-së.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-se, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tersi vendimeve të këtij organi dhe dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - K.K. SKENDERAJ**
- **OE - Horn & Co. Kosova SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: